

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën e kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitete përgjatë muajit Maj, 2022

Konferenca rajonale “Kultura e integritetit” si një mekanizëm në luftën kundër korrupsionit

22-24.5.2022: Ministria e Drejtësisë mori pjesë në konferencën rajonale të nivelit të lartë “Kultura e Integritetit: Forcimi i Parandalimit të Korrupsionit”, organizuar nga Šibenik të Kroacisë, me pjesëmarrjen e delegacioneve politike të 6 vendeve të Evropës Juglindore. Konferenca e organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Administratës Publike dhe organizata Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Transnacional - GI-TOC, ishte një nismë e cila mbledhi bashkë drejtues politikë të fushës së drejtësisë, zyrtarë të lartë të gjyqësorit dhe administratës publike dhe përfaqësues të organizatave civile, fushës akademike. Në konferencë u diskutua për çështje të luftës kundër korrupsionit dhe forcimit të integritetit në administratën publike. Delegacioni shqiptar i drejtuar nga zëvendësministria e Drejtësisë, znj. Pirdeni, ndau eksperiencën e vendit për forcimin e integritetit në administratën publike, një angazhim që vjen i përmbushur edhe në përgjigje të rekomandimeve të dhëna vendit nga Bashkimi Evropian. Konferenca ishte një vend takimi dhe ndarje idesh për bashkëpunimin e kësaj iniciative mes vendeve si një mekanizëm thelbësor kundër korrupsionit.



Delegacioni i Qeverisë Shqiptare përgatitet për raportimin në GRECO, seanca plenare e vlerësimit

09.05.2022. Delegacioni i Qeverisë Shqiptare nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë zhvilloi një seancë trajnimi të organizuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Shqipëri. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin përfaqësues të institucioneve të Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrisë, ministrive të linjës, ILDKPKI-së, autoriteteve ligjzbatuese si Policia së Shtetit, Prokuroria dhe Agjencia e Mbrojtjes Policore. Pjesëmarrësve iu ofruan shëmbuj praktikë diskutimi dhe prezantimi në GRECO me qëllim sigurimin e një marrëdhënie efektive me këtë autoritet të lartë vlerësues. Grupi shqiptar që do të përfaqësojë arritjet e Shqipërisë në GRECO mori eksperiencën e dy ekspertëve të Këshillit të Evropës, të ish-presidentit të GRECO z. Drago Kos dhe ish anëtarit të Byrosë, z. Edmond Dunga.



Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://www.coe.int/sq/web/tirana/news/>

Vizitë studimore për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në Shqipëri


30-31.5.2022: Në kuadër të finalizimit të analizës paraprake ligjore dhe institucionale për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në vend, proces ky i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, është zhvilluar një vizitë studimore në Paris, Francë, me asistencën e GIZ Albania. Delegacioni Shqiptar u bashkëudhëhoq nga Znj. Adea Pirdeni, Zv. Ministër i Drejtësisë dhe Z. Besfort Lamallari, Zv. Ministër i Brendshëm, dhe pati në përbërje staf teknik dhe drejtues në nivel administrativ nga Ministria e Drejtësisë, Policia e Shtetit, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Qëllimi i vizitës studimore ishte shkëmbimi i drejtpërdrejtë i autoriteteve shqiptare me autoritetet franceze që ndajnë kompetenca në fushën e rikuperimit të asetëve, për të vëzhguar nga afër funksionimin potencial të modelit të përzgjedhur për Zyrën Shqiptare të Rikuperimit të Asetëve që do të ngrihet në vijim. Delegacioni Shqiptar zhvilloi takime me Agjencinë për Manaxhimin e Asetëve të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Platformën për Identifikimin e Asetëve Kriminale, Ministrinë homologe Franceze të Drejtësisë dhe të Brendshme, si dhe me strukturat përgjegjëse për integrimin në kuadër të Kapitullit 23 dhe 24, duke parë rëndësinë që ngritja e Zyrës ka në performancën e Shqipërisë në rrugëtimin e integritetit evropian.



Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar-mars 2022, në proces konsultimi

01- 24.05.2022. Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka monitoruar zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion për periudhën janar-mars 2022 dhe ka hartuar drafti raportin e monitorimit. Ky raport monitorimi jep një informacion mbi progresin e Planit të Veprimit Antikorrupsion për 58 masa dhe 108 aktivitete të planifikuara për zbatim për këtë periudhë, në fusha të parandalimit – ndëshkimit – ndërgjegjësimit kundër korrupsionit. Nga monitorimi i kryer rezulton se janë zbatuar plotësisht 23 masa/58 aktivitete, pjesërisht 17 masa/11 aktivitete dhe nuk janë zbatuar 18 masa/39 aktivitete për të cilat pritet ende raportimi i institucioneve zbatuese. Fusha me nivel zbatimi të mirë edhe në këtë 3-mujor të parë të vitit 2022 janë e-shërbimet (1 225 në total), 120 autoritete publike kanë instaluar e-regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve, ministritë kanë miratuar planeve të integritetit, është rritur ndërveprimi i masave ndëshkimore antikorrupsion në nivel administrativ dhe agjenci ligjzbatuese (polici-SHCBA-prokurori). Draft-raporti i monitorimit është në proces konsultimi institucional me të gjitha institucionet raportuese dhe me publikun e gjerë dhe OSHC-të. Raporti pas dakordësimit në takimin në Grupit Teknik Tematik Antikorrupsion do të diskutohet dhe miratohet në takimin e Grupit Tematik Antikorrupsion, në muajin qershor 2022.

Raporti i Monitorimit janar-mars, 2022 mund të aksesohet në këtë link: <https://www.drejtesia.gov.al/viti-2022-2/>



Projekti “Kurrikula Antikorrupsion” në shkollat e arsimit të mesëm, Tiranë, mbyllet me sukses

09.05.2022. Projekti “Kurrikula antikorrupsion” është finalizuar me sukses, duke shënuar kështu të parin projekt bashkëpunimi me partnerë të rinjtë e shkollave të mesme të Tiranës, të angazhuar në luftë kundër korrupsionit. Ministri i Drejtësisë z.Manja, Ministri i Arsimit dhe Sportit znj.Kushi, Ambasadori i Italisë në Tiranë z. Bucci, sëbashku me presidentin e shoqatës Avviso Pubblico në Itali z. Romani, inauguruan punët krijuese të nxënësve të 4 shkollave të mesme ku u zhvillua për një vit shkollor projekti i përbashkët kundër korrupsionit. Njohuritë e marra për luftën kundër korrupsionit, njohja dhe aplikimi i instrumentave denoncuese kundër korrupsionit u përcollën nëpërmjet punëve të ndryshme krijuese të nxënësve. Aktiviteti përmbyllës u zhvillua në ambientet e shkollës “Qemal Stafa” dhe nxënësve iu shpëndanë certifikata pjesëmarrjeje dhe vlerësimi për idetë e tyre inovative kundër korrupsionit. Ky projekt bashkëpunimi është i pari i këtij organizimi ku roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit afrohet më pranë të rinjve dhe përmirëson bashkëpunimin me ta.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://www.facebook.com/drejtesia.gov.al>



Takim me studentët e Fakultetit të Ekonomisë në Tiranë

06 - 10.05.2022. Viojnë takimet dhe bashkëpunimet me të rinjtë studentë të Universitetit të Tiranës, kundër korrupsionit. Projekti i Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë ka vijuar gjatë këtij muaji me takimet me të rinj studentë, për të rritur ndërgjegjësimin publik kundër korrupsionit. Ekspertët e delegacionit të Asistencës Teknike zhvilluan një takim të dedikuar në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës, me qëllim promovimin e kulturës së ligjshmërisë dhe përdorimin nga të rinjtë të mjeteve efektive për të denoncuar korrupsionin. Takimi shënoi një interes të shtuar të të rinjve dhe përmirësoi nivelin e ndërgjegjësimit publik në këtë fushë.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://www.facebook.com/drejtesia.gov.al>



Fushatë ndërgjegjësimi kundër korrupsionit në Universitetin Politeknik Tiranë

09.05.2022. Viojnë bashkëpunimi i Ministrisë së Drejtësisë me Projektin e Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, e cila synon forcimin e kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik në luftën kundër korrupsionit. Në këtë kuadër, u promovua edhe një video e re e luftës kundër korrupsionit në fasadën qendrore të Universitetit Politeknik në Tiranë, me mesazhe të drejtëpërdrejta dhe thirrje kundër korrupsionit. Ministria e Drejtësisë realizon kështu një nga disa fushatat publike të planifikuara përgjatë vitit 2022. Rritja e ndërgjegjësimit publik në këtë aspekt, ka një rëndësi të veçantë sa i takon përfshirjes së qytetarëve në mënyrë aktive për të njohur format e korrupsionit dhe për ta denoncuar atë.



Forcimi kapacitetesh për Vlerësimi i riskut të korrupsionit dhe vlerësimi i hapësirave ligjore për korrupsion në sektorin e ndërmarrjeve publike dhe arsimin e lartë



12 - 13.05.2022. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me organizatën Iniciativa Rajonale Antikorrupsion – RAI, ka mundësuar kryerjen e një trajnimi dy-ditor për vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe vlerësimin e hapësirave që ligjet mund të krijojnë për korrupsion (*corruption proofing of legislation*), për specialistë të fushave që veprojnë në administrimin e ndërmarrjeve publike dhe të fushës së arsimit të lartë. Specialistë të hartimit të politikave në këto dy sektorë, auditë financiare dhe të kontrollit, juristë të ministrive të Financës dhe Ekonomisë dhe të Arsimit dhe Sportit së bashku me ekspertë të fushës antikorrupsion dhe të hartimit të ligjeve pranë Ministrisë së Drejtësisë ndoqën trajnimin e përgatitur nga trajnerë dhe ekspertë të RAI. Trajnimi u përqëndrua në aplikimin e metodologjive të vlerësimit se si vlerësimi i riskut të korrupsionit të këto dy sektorë por edhe procesi i vlerësimit të legjislacionit të fushës do të kryhet në pararendje të marrjes së masave kur parashikohen apo kërkohen ndryshime në vendimmarrje dhe rishikime politikash. Aplikimi i këtyre metodologjive të vlerësimit të korrupsionit synon unifikimin e procedurave dhe njëtrajtësimin e tyre në të gjithë vendet e Ballkanit, një nismë e mundësuar nga projekti Projekti Evropa Juglindore – Së bashku kundër Korrupsionit, mundësuar nga RAI.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://rai-see.org/rai-secretariat-organized-training-for-higher-education-and-public-enterprises-sector/>



Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit rrit bashkëpunimin ndërkombëtar në mekanizmat e parandalimit dhe ndërgjegjësimin antikorrupsion

10.05.2022. Rrjeti i Agjencive Parandaluese kundër Korrupsionit – NCPA, në të cilin Ministria e Drejtësisë është anëtare e Komitetit Drejtues u mbledh në mbledhjen e dytë plenare për vitin 2022. Sekretariati Teknik i NCPA detyra e të cilit kryhet nga Autoriteti Greke Kombëtarë i Transparencës informoi vendet anëtarë për planin e punës për vitin 2022 dhe iniciativat e nisura për zhvillim nga vendet, sic përmenden 1) organizimi i webinarëve për çështje specifike të integritetit publik, 2) zhvillimi i guidave/udhëzuesve për parandalimin e korrupsionit, 3) organizimi i vizitave studimore dhe 4) iniciativat mbi komunikimin dhe vizibilitetin kundër korrupsionit. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë në rolin e saj të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit po bashkëdrejton me agjencinë italiane kundër korrupsionit – ANAC, hartimin e një guide/metodologjie studimore dhe krahasuese mbi modelet dhe procedurat e hartimit të strategjive dhe planeve të veprimit antikorrupsion në vendet anëtare të NCPA. Për këtë qëllim është hartuar dhe shpërndarë një pyetësorë për plotësim, që do të shërbejë si bazë e mirë për hartimin e këtij dokumenti. Gjithashtu, një vizitë studimore do të organizohet në Tiranë në muajt në vijim. Bashkëpunimi me NCPA dhe roli aktiv në të, ka rritur angazhimin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtare.



Ministria e Drejtësisë publikon raportin e monitorimit të Planit të Integritetit për vitin 2021

12 - 13.05.2022. Në vijim të procesit të forcimit të integritetit në administratën publike, Ministria e Drejtësisë publikoi gjatë muajit maj, raportin e monitorimit të Planit të saj të Integritetit për vitin 2021, duke u bërë kështu institucioni i parë publik që zhvillon këtë proces. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në vend, ka zhvilluar gjithashtu procesin e koordinimit gjatë hartimit të planeve të integritetit në herët nga ministrinë e linjës. Raporti i monitorimit për vitin 2021 paraqet analizën vjetore dhe gjetjet kryesore, objektivat, konkluzionet dhe rekomandimet.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://www.drejtesia.gov.al/instrumente-antikorrupsioni/>

